



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 139 Datë 08.10.2012

PËR

**NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË KUOTAVE TË KAPITALIT
THEMELTAR TË SHOQËRISË HEC-I DRAGOSTUNJE SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 6.2, të “Liçensës për prodhimin e energjisë elektrike” dhe pikës 5.2 të “Liçensës për tregtimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.10.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k, për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

1. Shoqëria Hec-i Dragostunje sh.p.k është liçensuar nga ERE përkatësisht:
 - ne aktivitetin e *Prodhimit të Energjisë Elektrike* nga Hec-et: “Zanore”; “Dragostunje”; “Hotolisht” dhe “Ura” me Vendimin e Bordit të Komisioneve Nr. 25, date 10.03.2011 dhe
 - ne aktivitetin e *Tregimit të Energjisë Elektrike* me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 26, date 10.03.2011.
2. Ristrukturimi i pjesëmarrjes së kapitalit që ka ndërmarrë shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k shkakton ndryshimin e aksionerit që kontrollon interesat.
3. Ndryshimi i aksionerit që kontrollon interesat e shoqërisë i shërben zhvillimit të projekteve koncesionare për fazat në vazhdim.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendos:

1. Të autorizojë shoqërinë “Hec-i Dragostunje” sh.p.k, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI